



REPUBLIKAE SHQIPËRISË  
BASHKIA GRAMSH  
DREJTORIA E SHËRBIMIT PYJOR, MJEDISIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT.  
SEKTORI I BUJQËSISË.

Nr 2549 prot

Gramsh, më 06.12 .2024

NJOFTIM

Bazuar në Udhëzimin e Këshillit të Ministrave Nr. 1, dt. 18/07/2012 Për "Procedurat e dhënies me qira të tokave bujqësore të pandara", të VKB nr. 71 dt. 31.10.2024 për "miratimin e dhënies me qira të pasurisë nr. 20.1, 20.2, 20.3 në fshatin Mashan, Njësia Administrative Kodovjat, Bashkia Gramsh dhe pasurisë nr. 43/30 në fshatin Bregas, Njësia Administrative Kushovë, Bashkia Gramsh". Urdhërit të Kryetarit të Bashkisë nr. 42 dt. 02.12.2024 "Për krijimin e komisionit për dhënien me qira të tokave bujqësore të pandara", njoftohen subjektet e interesuara për marrjen e tokave bujqësore me qira se procedurat e konkurimit do të zhvillohen, sipas orarit të mëposhtëm:

Për pasurinë nr. 20.1 me sipërfaqje 30300m<sup>2</sup>, 20.2 me sipërfaqje 30300 m<sup>2</sup>, 20.3 me sip. 30300 m<sup>2</sup> e llojit arë, ZK 2607, fshati Mashan, Njësia Administrative Kodovjat, Bashkia Gramsh procedurat e konkurimit do të zhvillohen në dt. 14.01.2025, ditën e martë, ora 10. Konkurimi do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të nënprefektura.

Për pasurinë nr. 43/30 me sip. 117500m<sup>2</sup> e llojit arë, ZK 1272 në fshatin Bregas, Njësia Administrative Kushovë, Bashkia Gramsh, procedurat e konkurimit do të zhvillohen në dt. 14.01.2025, ditën e martë, ora 11. Konkurimi do të zhvillohet në sallën e mbledhjeve të nënprefektura.

Dokumentat që do të sjellin çdo subjekt janë:

- 1 - Të dhënat e kërkuarit.
- 2 - Sipërfaqja dhe vendodhja e tokës bujqësore (hartë treguese, kartelë pasurie) e cila kërkohet të merret me qira, e identifikuar me nr. kadastral përkatës, të reflektuar në dokumentacionin e DAMT-së së qarkut ose me nr. e pasurisë të reflektuar në dokumentacionin e Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurisë së Paluajtshme (ZVRPP);
- 3 - Afatit i qirasë;
- 4 - Projektin teknik ku të jenë përcaktuar;
- 5 - Veprimtaria bujqësore që do të zhvillohet mbi tokën e marrë me qira, duke përcaktuar kulturat bujqësore ose llojet e bimëve me të cilat lidhet kjo veprimtari;

6-Aspektet kryesore të teknologjisë që do të aplikohet në kultivimin e bimëve, si dhe përpunimin e produkteve;

7-Investimet kryesore mbi infrastrukturën(kullim ,ujitjen ,sistemim) etj. Të shprehura në tregues fizik e monetar si dhe investimet e lidhura me mbjelljen e kultivimin e bimëve.

Burimet e financimit që garantojnë investimin, të shprehura në vlerë monetare ,ndikimin e investimeve në rritjen e numrit të punësuarve në bashkinë Gramsh,

8 - propozimin për çmimin e ofr uar për marjen e tokës bujqësore me qira ( lekë / ha në vit).

9 - Vërtetimin e lëshuar nga DAMT-ja e Qarkut Elbasan, ku tregohet kategoria e resursit të tokës bujqësore, siç rezulton në dokumentacionin kadastral, si dhe jepet informacioni për gjendjen e pronësisë së saj.

**Shënim** : Dokumentat pranohen vetëm origjinale.

Faleminderit për mirëkuptimin!

KRYETARI  
Besion Ajazi

